



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 42

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 22 tetor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale, Qarku Lezhë, nr. 703/1, datë 12.10.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “Fran Ndue Marku”, me NIPT: F30613016L..... 3
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 976, datë 15.10.2018	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor..... 4
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 5949, datë 16.10.2018	Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës “Vlerësimi i dinamikës së skemës NE, si pasojë e ndikimit të formulës së pikëzimit, me fokus targetimin te familjet e varfra, të përfituesve aktualë të skemës së NE-së në shkallë vendi”, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale..... 5
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 5949/1, datë 16.10.2018	Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës “Asistencë teknike për përgatitjen e përmirësimit ligjor/kuadri i ri ligjor mbi aftësinë e kufizuar”, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale..... 6
Njoftim i Institucionit të Komisionerëve Publikë nr. 429/4, datë 17.10.2018	Për pozicionet e lira të punës në Institucionin të Komisionerëve Publikë..... 7

**KËRKESË**

Nr. 703/1, datë 12.10.2018

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ
SUBJEKTIT “FRAN NDUE MARKU”, ME
NIPT: F30613016I**

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Lezhë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e dënimit nr. ISHMPUT-LE-2018-000086-5, datë 18.9.2018, nëpërmjet shërbimit

postar është kthyer njoftimi i ISHMPUT-së, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, adresë e panjohur.

Sa më sipër, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, dega Lezhë, bën njoftimin publik të aktit të vendimit të dënimit administrativ, respektivisht për subjektin **“Fran Ndue Marku”, me NIPT: F30613016I.**

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
Anisa Frroku

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT
DEGA RAJONALE E QARKUT LEZHË**

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-LE-2018-000086-5

Datë 18.9.2018

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-LE-2018-000086-2, datë 18.9.2018, inspektim që është zhvilluar në subjektin “Fran Ndue Marku”, NIPT: F30613016I, punëdhënës Fran Marku, prej datës 17.9.2018, 00:00 deri në datën 18.9.2018, 00:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 18.9.2018 dhe e njoftoi në datën 18.9.2018. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit, rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: 10448 29 1/b/III.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit, nuk ka, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative, si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 300.000 lekë.

2. Dënim administrativ plotësues:

- Pezullim i aktivitetit deri në pajisjen me leje mjedisore, sipas shtojcës nr. 60/2014 ID 7.8.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Klevis Lelcaj ID:

Ismail Dushkaj ID:

Kundër vendimit përfundimtar, subjekti “Fran Ndue Marku” ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “organit epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.



NJOFTIM

Nr. 976, datë 15.10.2018

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
DREJTORISË SË SHËRBIMIT PYJOR**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, shpall për shitje si më poshtë:

1. Në administrim të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)				Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)
			Vlera fillestare e shitjes (mjete kryesore + mjete xhiroje)	Mjetet kryesore	Mjetet e xhiros	Trualli		
1	5 objekte: ndërtesë e degës teknike, magazinë qendër, kaponet e makinave, kaponet e makinave (Tojota) kaponon rrëshire (magazinë)	Dibër	19 219 738	19 219 738	0	2 545 352	746	746

Subjekti i shpronësuar i truallit, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë brenda afatit të publikimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë, se, që

nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfutur kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të publikimit. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Shënim. Publikimi bëhet për ish-pronarët e truallit të subjektit të shpronësuar Nazif Shulku.

Afati i publikimit fillon në datën 15.10.2018 dhe mbaron në datën 13.11.2018.

**KËRKESË**

Nr. 5949, datë 16.10.2018

**PËR SHPREHJE INTERESI
PËR SHËRBIMIN E KONSULENCËS
“VLERËSIMI I DINAMIKËS SË SKEMËS
NE, SI PASOJË E NDIKIMIT TË
FORMULËS SË PIKËZIMIT, ME FOKUS
TARGETIMIN TE FAMILJET E VARFRA,
TË PËRFITUESVE AKTUALE TË
SKEMËS SË NE-së NË SHKALLË
VENDI”, PËRFITUES I SË CILËS ËSHTË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE**

Numër reference: SAMP/CS/CQ/04-2015

Tiranë 15.10.2018

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Hua nr. 8141-AL

Nr. i identifikimit të projektit: P122233

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar ta përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës lokale (shërbimi) përfshin: **“Vlerësimi i dinamikës së skemës NE, si pasojë e ndikimit të formulës së pikëzimit, me fokus targetimin te familjet e varfra, të përfituesve aktualë të skemës së NE-së në shkallë vendi”**.

Qëllimi i këtij studimi është të kontrollojë/të verifikojë saktësinë e informacionit të ofruar nga aplikantët/përfituesit (si një *spot-check*/auditim), si dhe të kuptojë karakteristikat e familjeve përfituese.

Në bashkëpunim të ngushtë me dhe nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kompania lokale do të jetë përgjegjëse për auditimin e statusit aktual të mirëqenies së përfituesve të NE-së dhe karakteristikat e tyre në mbarë vendin, përmes verifikimit të kushteve të ekonomisë familjare, bazuar në informacionin e dhënë në formularët përkatës të aplikimit. Pra, studimi (përmes një auditimi/verifikimi) do të mbledhë (dhe do të verifikojë) informacionin që është dhënë në aplikim, por do të mbledhë dhe disa informacione

shtesë për të kuptuar më mirë gjendjen dhe karakteristikat/mirëqenien e familjeve të përfituesve, për të identifikuar rastet e abuzimit në të gjithë vendin nga ana e verifikimit të rasteve të rastësishme, për të analizuar procesin individual të vlerësimit të kryer në njësitë administrative. Ky proces do të ndihmojë në verifikimin e informacionit në aplikacionin e dhënë nga përfituesit përmes auditimit të statusit të tyre të mirëqenies në vend.

Studimi do të përfshijë vizita në shtëpitë e përfituesve (të grupit të përzgjedhur) në të 12-të rajonet (duke u siguruar që grupi i familjeve të përzgjedhura të jetë përfaqësuese e familjeve përfituese), e barabartë me rreth 1,500 familje, bazuar në të dhënat e informuara nga SHSSH-ja, të depozituara në Sistemin e ri të Menaxhimit të Informacionit (MIS).

Konsulenti duhet të ketë dëshmuar për sukses në kryerjen e detyrave të ngjashme. Duhet të ketë një skuadër shumëdisiplinore, e cila ka përvojë dhe njohuri të konsiderueshme me programet e ndihmës sociale dhe njohuri të qëndrueshme të zhvillimit procedural, institucional dhe shoqëror në përgjithësi. Ekipi i konsulentit duhet të ketë së paku në përbërjen e tij: udhëheqës të ekipit, ekspert të statistikave të *Samplingut* dhe të anketimit, ekspert social etj.

Firma konsulente mund të punësojë ekspertë të tjerë për të zbatuar detyrën me standarde të larta.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP), fton të gjitha kompanitë konsulente lokale (konsulente) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimit të kërkuar. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet.

Kriteret e shortlistimit janë:

Kriteret e shortlistimit	Pikët
Ekspierienca e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e shërbimit	10 pikë
Numri i kontratave që kanë lidhje me shërbimin, të përfunduara gjatë tri viteve të fundit	10 pikë
Ekspierienca e përgjithshme dhe kualifikimet e stafit kryesor	20 pikë
Ekspierienca specifike në fushën e shërbimit dhe kualifikimet e stafit kryesor	50 pikë
Numri i viteve pranë firmës të stafit kryesor	10 pikë
TOTALI	100 pikë



Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore, për: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA-së, dhe grante nga huamarrësit e Bankës Botërore* (Udhëzuesi i konsulencës, version i janarit të 2011-ës).

Shërbimi do të kryhet nga një kompani konsulente. Metoda e përzgjedhjes do të jetë: Kualifikimet e konsulentëve (CQ), në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzuesit e Bankës Botërore: *Përzgjedhja e punësimit i konsulentëve të Bankës Botërore (botimi 2011)*.

Shërbimi pritet të fillojë në shtator 2018 dhe të përfundojë në dhjetor 2018. Kompania lokale do të kontraktohet sipas një kontrate *lump-sum*.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00–16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *e-mail*) deri më **29 tetor 2018**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Rruga e Kavajës, AL-1001, Tiranë, Albania

Në vëmendje të znj. Suzana Papadhopulli

e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

KËRKESË

Nr. 5949/1, datë 16.10.2018

PËR SHPREHJE INTERESI PËR SHËRBIMIN E KONSULENCËS “ASISTENCË TEKNIKE PËR PËRGATITJEN E PËRMIRËSIMIT LIGJOR/KUADRI I RI LIGJOR MBI AFTËSINË E KUFIZUAR”, PËRFITUES I SË CILËS ËSHTË MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Numër reference: SAMP/CS/CQ/02-2018-A

Tiranë 15.10.2018

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Hua nr. 8141-AL

Nr. i identifikimit të projektit: P122233

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar ta përdorë një pjesë të saj për shërbime konsulence. Shërbimi i konsulencës (shërbimi) përfshin: **“Asistencë teknike për përgatitjen e përmirësimit ligjor/kuadri i ri ligjor mbi aftësinë e kufizuar”**.

Nën drejtimin e përgjithshëm të Departamentit të Programeve për Zhvillimin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, konsulenti pritet të ndërmarrë përgatitjen e të gjithë paketës legjislative për zbatimin e modelit të ri të vlerësimit të PAK-së, në bazë të të gjithë dokumentacionit të reformës dhe aspekteve të identifikuar të ligjeve dhe nënligjeve që duhet të ndryshojnë për të siguruar përputhjen me objektivat e reformës. I gjithë ky proces do të paraprihet nga një dokument i politikave, që shërben si udhërrëfyes për hartimin e një baze të re ligjore, në lidhje me sistemin e ri të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Më konkretisht, konsulenti do të ndërmarrë këto detyra:

- Përgatitjen e ndërhyrjeve në paketën aktuale legjislative, ligjet, aktet nënligjore (VKM-të, udhëzimet, urdhrat, rregulloret etj.) dhe paketën e re legjislative për implementimin e pritshëm kombëtar të modelit të ri, në bazë të materialeve të reformës në tri rajone. Paketa e re legjislative do



të përfshijë aktet ekzistuese ligjore/nënligjore, që janë subjekt i rishikimit dhe i ri që do të zhvillohet, së bashku me raportet e tyre shpjeguese dhe tabelën e përputhshmërisë së akteve të hartuara me *acquis communautaire*.

- Hartimin e dokumentacionit përfundimtar ligjor për funksionimin e administratës së re të vlerësimit, si dhe marrëveshjet/marrëveshjet ndërinstitucionale në bazë të dokumenteve të reformës.

Konsulenti duhet të dëshmojë kryerjen me sukses të detyrave të ngjashme. Duhet të ketë një ekip shumëdisiplinor, i cili ka përvojë dhe njohuri të konsiderueshme për mbrojtjen sociale, veçanërisht me programin e asistencës për aftësinë e kufizuar dhe kuptimin e bazës solide të zhvillimit procedural, institucional dhe shoqëror në përgjithësi. Konsulenti duhet të ketë të paktën 5 vjet në biznes.

Ky shërbim kërkon një ekip të përbërë nga një ekspert social me eksperiencë të gjerë në fushën e aftësisë së kufizuar, një ekspert ligjor me përvojë të gjatë në analizën dhe përgatitjen e kuadrit ligjor.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (PMT), fton të gjitha kompanitë konsulente të pranueshme (konsulente) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet.

Kriteret e shortlistimit dhe të vlerësimit janë:

Kriteret		Pikët
1	Eksperiencia e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e shërbimit	20
2	Numri i shërbimeve/kontratave të kryera gjatë tri viteve të fundit	30
3	Eksperiencia e përgjithshme dhe kualifikimi i ekspertëve kryesorë	10
4	Eksperiencia dhe kualifikime të ngjashme me këtë shërbim të stafit kryesor	40
TOTAL		100

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore për: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA-së, dhe grante nga huamarrësit e Bankës Botërore (Udhëzuesi i konsulentëve, version i janarit të 2011-ës).

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një joint *venture* apo në formën e nënkontraktimit për të forcuar kualifikimet e tyre.

Konsulenti duhet të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është: “Përzgjedhje sipas kualifikimit të konsulentit”, CQ, në përputhje me procedurat e udhëzuesve të Bankës Botërore për përzgjedhjen e punësimit e konsulentëve (botim i janarit 2011).

Konsulenti pritët të fillojë shërbimin në tetor 2018 dhe ta përfundojë atë në dhjetor 2018.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00–16:00 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *e-mail*) deri më 29 tetor 2018.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)
Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Rruga e Kavajës, AL-1001, Tiranë, Albania
Në vëmendje të znj. Suzana Papadhopulli
e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

NJOFTIM

Nr. 429/4, datë 17.10.2018

PËR POZICIONET E LIRA TË PUNËS NË INSTITUCIONIN TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Institucionit të Komisionerëve Publikë”, të ndryshuar, me vendimin e Kuvendit nr. 102/2018, shpall vendet vakante për pozicionin këshilltar ekonomik dhe ligjor, në njësinë ligjore të institucionit:

I. KUSHTET E POSAÇME

Këshilltarë ekonomikë: 2 vende (paga 80% e pagës G3)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijojnë:



1. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkencë ekonomike, në matematikë ose në drejtësi, me diplomë “master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për shkencë ekonomike, në matematikë ose në drejtësi jashtë vendit dhe të ketë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj.

2. Të ketë një përvojë pune në sektorin financiar, jo më pak se 7 vjet.

3. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, si dhe ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal.

4. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore për largim nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

5. Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

Këshilltarë juristë: 2 vende (paga 80% e pagës G3)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijojnë:

1. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe të ketë marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj.

2. Të ketë pasur një përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose administratën publike jo më pak se 7 vjet.

3. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, si dhe ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal.

4. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore për largim nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

5. Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

II. KUSHTET E PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Kandidatët duhet të paraqesin vetëdeklaratë që nuk kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit “Mbi të drejtën e informimit me

dokumentet e ish-Shërbimit të Sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

III. PARAQITJA E DOKUMENTACIONIT

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti nga data 5 deri më 9 nëntor 2018, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 8, Tiranë, nga e hëna në të premte, ora 09:00–16:00.

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 8, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 9 nëntor 2018 dhe të vërtetohet me fletëmandatin e lëshuar nga zyra postare.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant për të cilin është i interesuar.

Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon të mbyllura në zarf, 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

2. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim (ID), librezë pune) origjinale ose të noterizuara. Diplomat që janë marrë jashtë vendit duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal.

4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore.

5. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

6. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

7. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera, të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë depozituar dokumente të fotokopjuara, përpara intervistës ia parashitrojnë Komitetit *Ad-Hoc* dokumentet e njësuara ose ato origjinale.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2018